

KËSHILLI I KOMUNËS SË KËRÇOVËS

Nr. 08-3132/2

13.11.2025

K ë r ç o v ë

PROCESVERBAL

Nga seanca e 1-rë Konstituive e Këshillit të Komunës së Kërçovës, e mbajtur më datë 13.11.2025 në hapsirat e Këshillit të Komunës së Kërçovës me fillim në ora 10:00.

Seancën në ora 10:00 e hapi dhe me të udhëhoq kryetari i Këshillit të Komunës së Kërçovës Skender Xhabiri nga mandati paraprak i Këshillit, ndërsa të pranishëm ishin këshilltarët: Zhaneta Milanoska Petreska, Aleksandar Mickoski, Mihajlo Daniloski, Irena Naumoska, Violeta Stefanoska, Bojan Trajkoski, Dragan Dejanoski, Mirsad Ramazanovski, Ilir Rushani, Shefki Imeti, Latife Imani, Siarta Saliju Osmani, Asip Zendeli, Teuta Ahmedti Purellku, Ajhan Sulkovski, Fadil Emini, Kujtim Kasami, Beqir Osmani dhe Stevo Stefanoski.

Në seancë morën pjesë edhe: Kryetari Dr. Aleksandar Jovanovski, Valdet Selimi, Aneta Nasteska, Lence Srbinska, Mite Dimitrijoski, Arben Ristemi - përfaqësues të administratës komunale.

Në seancë morën pjesë edhe gazetarë nga: TV Uskana, TV Gurra, TV 21.

Skender Xhabiri - Ai thirri seancën e parë konstituive të këshillit, i përshëndeti të pranishmit dhe u uroi këshilltarëve punë të suksesshme, duke informuar se nuk ka vend për politikë në këshill dhe u kërkoi atyre të punojnë për të mirën e qytetit dhe të qytetarëve. Pastaj, ai informoi se sipas ligjit, rregullores së punës dhe statutit, puna e tij këtu mbaron dhe i bëri thirrje anëtarit më të vjetër të këshillit, Stevo Stefanoski, të vazhdojë të drejtojë seancën.

Stevo Stefanoski - Ai përshëndeti të pranishmit dhe uroi punë të suksesshme, të frytshme që Kërçova të jetë një qytet i suksesshëm.

Për këtë seancë propozoi rendin e ditës si vijojn:

R E N D I I D I T Ë S

1. Zgjedhja e Komisionit për verifikim, zgjedhje dhe emrim.
2. Verifikim i mandatit të anëtarve të Këshillit të komunës së Kërçovës.
3. Nëshkrimi i Deklaratës Solemne.
4. Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit të Komunës së Kërçovës.

Stevo Stefanoski - Rendin e ditës të propozuar e vendosi për miratim dhe i njëjti u miratua njëzëri me 19 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

U kalua në:

1. PIKA E PARË: Zgjedhja e Komisionit për verifikim, zgjedhje dhe emrim.

Mihajlo Daniloski - Ai përshëndeti të pranishmit. Ai uroi punë të frytshme dhe të suksesshme dhe propozoi Zhaneta Milanovska Petreska për pozicionin e Kryetares së Komisionit nga Koalicioni "Maqedonia Juaj" i udhëhequr nga VMRO DPMNE.

Valdet Selimi - Ai përshëndeti të pranishmit dhe informoi se 5 subjekte janë të përfaqësuara në këshill dhe kërkoi që ky komision të ketë përfaqësues nga të 5 grupet e këshilltarëve.

Fadil Emini - Ai përshëndeti të pranishmit dhe informoi se Teuta Ahmed Parelku është propozuar si anëtare e Komisionit nga Koalicioni VLEN.

Siarta Saliju Osmani - Ajo përshëndeti të pranishmit dhe si anëtar të Komisionit nga Aleanca Kombëtare për Integrim- AKI propozoi Ilir Rushanin.

Beqir Osmani - Ai përshëndeti të pranishmit dhe si anëtar të Komisionit nga Grupi i Votuesve propozoi Kujtim Kasamin.

Stevo Stefanoski - Nga koalicioni për zgjedhjet lokale 2025 udhëhequr nga LSDM, ai e propozoi veten si anëtar të Komisionit.

Stevo Stefanoski - Anëtarët e propozuar për Zgjedhjen e Komisionit për Verifikim, Zgjedhje dhe Emërime u vunë për miratim dhe u miratuan me 19 vota PËR, KUNDËR (asnjë), PËRMBAJTUR (asnjë).

Pastaj u dha një pauzë 5-minutëshe që Komisioni i Verifikimit të mbledhë dhe të shqyrtojë Çertifikatat për Verifikimin e mandateve të këshilltarëve. Pas pauzës, seanca vazhdoi me punime.

2. PIKA E DYTË: Verifikim i mandatit të anëtarve të Këshillit të komunës së Kërçovës.

Stevo Stefanoski - i bëri thirrje Kryetarit të Komisionit të shpjegojë Raportin e Komisionit për Verifikim.

Zhaneta Milanovska Petreska – I përshëndeti të pranishmit dhe uroi që të gjithë të bashkëpunojnë për të justifikuar besimin e qytetarëve që i zgjodhën. Ajo e shpjegoi Raportin e Komisionit dhe informoi se Komisioni ka arritur në përfundimin se nuk ka kundërshtime për identitetin e këshilltarëve dhe pengesa të tjera ligjore. Ajo propozoi që të miratohet Raporti dhe të verifikohen mandatet e të gjithë 19 këshilltarëve të zgjedhur të Këshillit të Komunës së Kërçovës.

Stevo Stefanoski – E vendosi për miratim Raportin e Komisionit për Verifikimin e Mandateve të Anëtarëve të Këshillit të Komunës së Kërçovës dhe i njejtë u miratua me 19 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

3. PIKA E TRETË: Nënshkrimi i Deklaratës Solemne

Këshilltarët e lexuan dhe nënshkruan Deklaratën Solemne me të cilën u zotuan se do ta kryejnë funksionin e tyre me ndërgjegje dhe përgjegjësi në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe rregulloret e këshillit.

4. PIKA E KATËRT: Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit të Komunës së Kërçovës.

Stevo Stefanoski - Hapi debat mbi pikën .

Fjalën e mori:

Teuta Ahmedi Parelku - Përsëndeti të pranishmit, uroi këshilltarët e zgjedhur për mandatin e tyre dhe propozoi Ajhan Sulkoskin për Kryetar të Këshillit.

Ilir Rushani - Përsëndeti të pranishmit dhe propozoi Siarta Saliju Osmanin për Kryetare të Këshillit.

Stevo Stefanoski e hodhi në votim propozimin për zgjedhjen e Ajhan Sulkoskit për Kryetar të Këshillit dhe i njëjti u miratua me 12 vota PËR. Konstatoi se Ajhan Sulkoski u zgjodh Kryetar i Këshillit.

Ajhan Sulkoski - I përshëndeti të pranishmit, mediat dhe administratën komunale, duke informuar se pranon besimin e treguar me përgjegjësi. Ai theksoi se Këshilli është një vatër e dialogut demokratik dhe se ai do të avokojë për punë transparente dhe marrjen e vendimeve të mira në interes të të gjithë qytetarëve. Ai shpreson për bashkëpunim të shkëlqyer me këshilltarët dhe që të gjithë të punojnë së bashku në mënyrë të pjekur dhe transparente.

Përsëkak se askush tjetër nuk e morri fjalën, dhe me këtë u shterë rendi i ditës për këtë seancë, ndërsa Kryetari i këshillit e mbylli seancën në ora 10 e 40.

Procesverbalist

-Lenqe Srbinoska

Përkthyes:Tefik Asani

Këshilli i Komunës së Kërçovës

Kryetar

Skender Xhabiri d.v.

